



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
I SANKSIONEVE

Data: 15 Maj 2021

Nr: 85

VENDIM

PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 54, PARAQITUR
NË KQZ NË DATËN 12.05.2021

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 15.05.2021, me pjesëmarrjen e:

Elvis ÇEFA - Relator
Elvin LAKO - Anëtar
Ilijan RUSMALI - Anëtar
Koli BELE - Anëtar
Ledio BRAHO - Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Pal Shkambi kandidati i mbështetur nga zgjedhësit në zonën zgjedhore qarku Shkodër;

OBJEKT: Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 54, paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve datë 12.05.2021.

BAZË LIGJORE: Nenet 21, 123/1, 124, 126, 129, 130 dhe 131 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 17 dhe 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” të Komisionit Rregullator.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,



VËREN:

Z. Pal Shkambi, kandidat i mbështetur nga zgjedhësit për zonën zgjedhore qarku Shkodër ka paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesë ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 54 regj., datë 12.05.2021.

Objekti i kësaj kërkesë është “Vënia në dispozicion e regjistrimeve të kamerave për ZAZ nr. 01, ZAZ nr. 02, ZAZ nr. 03, ZAZ nr. 04, ZAZ nr. 05, ZAZ nr. 06, ZAZ nr. 07 dhe ZAZ nr. 08”.

Në kërkesën e depozituar prej tij subjekti ankues parashtron se nisur nga rezultatet e fabrikuara të tabelave përmbledhëse të zonës zgjedhore qarku Shkodër, dhe kontaktet që subjekti ankues ka patur me disa zgjedhës pas këtyre rezultateve, konstaton se ka shumë tjetërsime të votave të zgjedhësve.

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) vëren se në thelb, objekti i kërkesës ankimore nr. 54, rregullohet nga paragrafi 4 i nenit 94 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“KQZ-ja vendos përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve (ekraneve) për shfaqjen e fletëve të votimit përpara vlerësimit të tyre. Kamerat me rezolucion të lartë instalohen mbi tavolinën e numërimit në mënyrë të tillë që bëjnë të mundur regjistrimin e vlerësimit të çdo flete votimi. Regjistrimi filmik transmetohet në kohë reale në monitorë të vendosur përballë vëzhguesve të subjekteve zgjedhore. Regjistrimi filmik i procesit ruhet në medie elektronike dhe dorëzohet në KQZ së bashku me materialet e tjera zgjedhore. **KQZ-ja ose, kur është e mundur, edhe KZAZ-ja, duhet të riprodhojë kopje të tyre dhe t’i vërë në dispozicion të subjekteve zgjedhore kundrejt pagesës së një tarife që mbulon koston e riprodhimit.”***

Ky proces dhe tarifat e caktuara, parashikohen edhe në Vendimin nr. 01, datë 22.01.2021 të Komisionit Rregullator për “Rregullat procedurale për përdorimin e kamerave regjistruese e monitorëve (ekraneve) në VNV dhe transmetimin në kohë reale nga VNV në KQZ”. Në pikën 4 të këtij vendimi përcaktohet se: *“Administrata e KQZ-së, ose kur është e mundur edhe KZAZ-ja, do të riprodhojë kopje të materialit të regjistruar dhe ti vërë në dispozicion të subjekteve zgjedhore, nëse i kërkojnë, sipas tarifave të përcaktuara sipas lidhjes 2 bashkëlidhur këtij vendimi”.*

Për sa më sipër, KAS arrin në përfundimin se kjo kërkesë është jashtë rrethit të kompetencave të këtij Komisioni të cilat listohen në nenin 21 të Kodit Zgjedhor, pra nuk plotëson kriterin e kërkuar nga neni 18, pika 1, shkronja “a” e Vendimit të Komisionit Rregullator nr. 3, datë 06.11.2020 “Për miratimin e Rregullores për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”



PËR SA MË SIPËR:

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 17, pika 3, shkronja “b” e 18, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” të Komisionit Rregullator

V E N D O S I:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 54, datë 12.05.2021, të paraqitur nga z. Pal Shkambi kandidati i mbështetur nga zgjedhësit në zonën zgjedhore qarku Shkodër.
2. Vënien në dispozicion nga KQZ të subjektit ankues regjistrimet e kamerave për ZAZ-të nr. 01-08 sipas objektit të kërkesës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

